



UNIVERSITETI “ISA BOLETINI”, MITROVICË
UNIVERSITY “ISA BOLETINI”, MITROVICA

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.uibm.net>; Tel: +383-28535725/535727

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2022
ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË

Mitrovicë, 2022

FUSHËVEPRIMI I ZYRËS

Duke u bazuar në Statutin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UIBM, Rregulloren e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në UIBM, zyra për sigurim të cilësisë është zyrë në kuadër të administratës qendrore të UIBM-it.

Zyra për sigurimin e cilësisë e UIBM është zyrë e pavarur e cila drejtpërdrejtë i raporton vetëm Rektorit të UIBM. Kjo zyrë, angazhohet në ngritjen e cilësisë në UIBM duke zbatuar të gjithë politikën institucionale. Zyra përbëhet nga zyrtarë për cilësi, të rekrutuar përmes konkursit publik. Zyrtarët e cilësisë në ZSC nuk janë pjesë e stafit akademik të UIBM. Zyra kujdeset për matjen e cilësisë, përmes të gjitha instrumenteve të paketës së instrumenteve në UIBM. Zyra harton raporte me gjetje dhe rekomandime për çdo pyetësor të zhvilluar, dhe atë e dërgon tek Rektori i UIBM. Po ashtu, zyra të dhënat nga pyetësorët i dërgon tek Dekani i njësisë akademike me qëllim të planifikimit për zhvillim të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Zyra ka për mision që të sigurojë nivel cilësor të mësimdhënies, mësim nxënies, programeve studimore, hulumtimit dhe administrimit të UIBM përmes implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe të sigurojë që mekanizmat dhe procedurat për arritjen e cilësisë të jenë funksionale. Përbushja e këtij misioni është në harmoni me misionin e institucionit dhe i shërben përbushjes së vizionit të tij për të qenë universiteti më i mirë publik në vend dhe rajon, dhe për të përgatitur kadro të cilat do të kontribuojnë zhvillimit të komunitetit lokal dhe global, në fusha specifike të studimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës janë:

1. Zbatimi i procedurave të cilat përfshijnë proceset dhe sistemin e vlerësimit;
2. Mbikëqyrë dhe ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të kontrollit të cilësisë përmes metodave-veprimeve të drejta dhe të përshtatshme;
3. Rishikon efikasitetin e sistemit të cilësisë dhe ofron përkrahje profesionale për KQSCV-në lidhur me procedurat e vlerësimit dhe hartimit të llojeve të ndryshme të pyetësorëve në UIBM dhe Fakultetet e UIBM;

4. Ndërmarrjen e veprimeve për vlerësimin sigurimit të cilësisë së programeve studimore dhe trajnuese, në bashkëpunim me menaxhmentin e fakultetit dhe zyrtarët përkatës të fakulteteve, me qëllim të arritjes së objektivave dhe kontrollit të cilësisë;
5. Bashkëpunimi me akterët relevantë në UIBM dhe fakultete në të gjitha fazat e veprimit për implementimin e sistemit të sigurimit dhe kontrollit të cilësisë;
6. Koordinimi dhe realizimi i aktiviteteve në lidhje me vetëvlerësimin e institucionit;
7. Përcaktimi i pikëve të kredive të fituara nga pjesëmarrësit në baze të kriterëve të përcaktuara, varësisht nga institucioni në të cilin aplikohet;
8. Përgatit raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për akreditim sipas legjislacionit në fuqi.

Me qëllim të arritjes së objektivave institucionale, dhe për të siguruar se Universiteti funksionon në përputhje me kërkesat ligjore dhe sipas praktikave më të mira, Zyra, për vitin 2022, ka në prioritet realizimin e këtyre objektivave:

Objektivi 1: Plotësim-ndryshimi dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike për funksionimin e zyrës për cilësi.			
Objektivi specifik	Aktivitetet	Afati	
1.1. Plotësim-ndryshimi i rregullores për cilësi	- Krijimi i grupit punues - Organizimi i takimeve të punës së bashku me KQSV-në - Mbledhja e rekomandimeve - Dërgimi për aprovim në Këshillin Drejtues	TM1 TM4	
1.2. Plotësim - Ndryshimi i udhëzuesit për cilësi	- Krijimi i grupit punues - Organizimi i takimeve të punës - Mbledhja e rekomandimeve - Aprovimi i udhëzuesit në KQSCV	TM1 TM4	
1.3. Aprovimi i ndryshimeve të paketës së instrumenteve për matjen e cilësisë	- Kontributi në përpilimin e instrumentave për matjen e cilësisë - Grumbullimi i instrumentave për matjen	TM3- TM4	

	e cilësisë dhe aprovimi në KQSCV. - Publikimi i paketës së instrumentave për matjen e cilësisë në ueb.		
1.4. Përmirësimi i SEVC-it	- Hulumtimi dhe evidentimi i mangësive në sistem. - Krijimi i moduleve sipas kërkesave të ZSC-së.	TM1- TM4	

Objektivi 2: Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i cilësisë në UIBM.			
Objektivi specifik	Aktivitetet	Afati	
2.1. Vlerësimi i studentëve	- Pyetësi me studentët Bachelor - Pyetësi me studentët Master - Pyetësi për vlerësimin e shërbimeve në UIBM. - Publikimi i raporteve	TM1 - TM2 TM4 TM2	
2.2. Vlerësimi i stafit akademik	- Pyetësi për vlerësimin e shërbimeve në UIBM - Pyetësi për vlerësimin e punës e Dekanëve - Pyetësi për vetëvlerësimin e stafit - Publikimi i raporteve	TM2 TM3 TM2	
2.3. Vlerësimi i Rektorit	- Pyetësi për vlerësimin e dekanëve nga Rektori - Publikimi i raportit	TM3	
2.4. Vlerësimi i Dekanëve	Pyetësi për vlerësimin e stafit akademik nga Dekani - Pyetësi i vetëvlerësimit të dekanëve - Publikimi i raporteve	TM2 TM3	
2.5. Vlerësimi nga ALUMNI	- Pyetësi me studentët ALUMNI	TM3	

	- Publikimi i raporteve		
2.6. Vlerësimi nga palët e jashtme të interesit	- Pyetëtori për vlerësimin nga palët e jashtme të interesit. - Publikimi i raporteve	TM3	

Objektivi 3: Ngritja e vazhdueshme e cilësisë në UIBM.

Objektivi specifik	Aktivitetet	Afati	
3.1. Takime të rregullta	- Takime të rregullta me koordinatoret për cilësi në njësitë akademike. - Takime të rregullta me KQSCV-në - Takime të rregullta me menaxhmentin	TM1- TM4	
3.2. Organizimi i trajnimeve	- Trajnim me stafin akademik për ECTS - Trajnim me stafin administrativ për ECTS - Trajnim me studentë për ECTS	TM1 TM4 TM1	
3.3. Treguesit kryesor të performancës në UIBM	- Mbledhja e të dhënave për treguesit e performancës - Përgatitja e raportit me treguesit e performancës - Publikimi i treguesve të performancës	TM4	
3.4 Zhvillimi i instrumentave të reja të cilësisë	- Hulumtimi për instrumenta të reja të vlerësimit të cilësisë. - Zbatimi i instrumentave të reja të vlerësimit.	TM1- TM4	

Objektivi 4: Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për cilësi

Objektivi specifik	Aktivitetet	Afati	
4.1. Përgatitja për anëtarësim në Asociacionin e Universiteteve Europiane -	- Mbledhja e informatave për anëtarësim në EUA - Përgatitja e raportit vlerësues mbi	TM1-	

EUA	rëndësinë dhe nevojën e anëtarësimit në EUA - Krijimi i grupit punues për anëtarësim - Përgatitja e dokumentacioneve dhe procedurave të tjera për anëtarësim nëse vlerësohet nga menaxhmenti.	TM4	
4.2. Përgatitja për anëtarësim në Unionin e Studentëve European	- Mbledhja e informatave për anëtarësim në USE - Përgatitja e raportit vlerësues mbi rëndësinë dhe nevojën e anëtarësimit në USE. - Krijimi i grupit punues për anëtarësim nëse vlerësohet nga menaxhmenti.	TM1- TM4	
4.3. Bashkëpunimi me organizata vendore dhe ndërkombëtare që merren me cilësi në arsimin e lartë.	- Hulumtimi i organizatave që merren me fushën e cilësisë në arsimin e lartë. - Kontakti me organizata vendore dhe ndërkombëtare dhe krijimi i bashkëpunimit.	TM1- TM4	

T1 – Tremujori i parë

T2 – Tremujori i dytë

T3 – Tremujori i tretë

T4 – Tremujori i katërt

Përveç objektivave të lartcekura, Zyra do të sigurojë zbatimin e të gjitha procedurave, detyrave dhe përgjegjësiave tjera të parapara.

Zyrtarë i lartë për sigurim të cilësisë